

VENDIM
Nr. 90/2015

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN
E LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË DETYRË NË ADMINISTRATËN
SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE,
PËR PERIUDHËN 15 SHTATOR 2013 – 30 SHTATOR 2015**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore.

II. Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor është verifikimi i të dhënave për fenomenin e emërimeve të kundërligjshme dhe politike në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, për periudhën 15 shtator 2013 – 30 shtator 2015, duke përfshirë emërimin e personave që kanë kryer veprime kriminale apo trafikim të lëndëve narkotike.

III. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

IV. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë. Kryetari dhe 3 anëtarë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Zëvendës-kryetari dhe 4 anëtarë përfaqësues të grupeve parlamentare të partive të maxhorancës si më poshtë:

- | | | |
|------------------|-----------------|-------|
| 1. Genc Pollo | Kryetar | (PD) |
| 2. Musa Ulqini | Zëvendëskryetar | (PS) |
| 3. Evis Kushi | Anëtare | (PS) |
| 4. Anila Agalliu | Anëtare | (PS) |
| 5. Ulsi Manja | Anëtar | (PS) |
| 6. Bujar Derveni | Anëtar | (LSI) |
| 7. Luçiano Boçi | Anëtar | (PD) |
| 8. Keltis Kruja | Anëtar | (PD) |
| 9. Alban Zeneli | Anëtar | (PD) |

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 5- mujor nga momenti i konstituimit.

VII. Komisioni, me kërkesën e çdo anëtar, miraton pa votim thirrjen dhe caktimin e ekspertëve të jashtëm, që e asistojnë komisionin në veprimtarinë e tij.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet dhe informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit "Për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë të realizuara gjatë periudhës 15 shtator 2013 deri më 31 maj 2014, në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore", të ngritur me vendimin nr. 82/2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

X. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhreve të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 22.10.2015